



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE
SIGURISË PUBLIKE

Nr. 738/1 prot.

Tiranë, më 27.02.2025

Lënda: Mbi bashkërendimin e projektligjit “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 5258/11 prot., datë 20.02.2025, protokolluar me tonën me nr. 738 prot., datë 21.02.2025, me anë të së cilës dërgoni për bashkërendim projektligjin “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë” (në vijim, “projektligji”), relacionin shoqërues, Tabelat e Përputhshmërisë me legjislacionin evropian, si dhe Raportin e Vlerësimit të Ndikimit (RIA).

Nga shqyrtimi i Tabelave të Përputhshmërisë (ToC), bashkëlidhur shkresës suaj, konstatojmë se me këtë projektligj synohet përafrim i pjesshëm me Direktivën e Këshillit Evropian 2004/82, datë 29 prill 2004 “Për detyrimin e transportuesve për të komunikuar të dhënat për pasagjerët” dhe Direktivën e (BE) 2016/681 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian, datë 27 prill 2016 “Për përdorimin e të dhënave për emrin e pasagjerëve (PNR) për parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të veprave terroriste dhe krimin të rëndë”.

Harmonizimi i projektligjit “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë” me legjislacionin kombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale, është një detyrim shumë i rëndësishëm, duke pasur parasysh jo vetëm proceset përpunuese të të dhënave personale që parashikon nga ky projektligj, por edhe rëndësinë e zbatimit të legjislacionit kombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale.

Nga shqyrtimi i projektligjit të ridërguar, Zyra e Komisionerit vlerëson në tërësi marrjen në konsideratë të sugjerimeve të dhëna nga ana jonë, me shkresën nr. 2369/1 prot., datë 13.11.2024, të cilat janë përfshirë konkretisht në germën “e”, të pikës 2, të nenit 3, pikën 6, të nenit 3, pikën 5, të nenit 6, pikën 3, të nenit 9 dhe nenin 11 të tij.

Megjithatë, me qëllim që ky projektligj të jetë në të njëjtën linjë me zhvillimet e fushës së mbrojtjes së të dhënave personale, vlerësojmë nevojën e disa saktësimeve dhe korigjimeve, të cilat i ridërgojmë, si më poshtë vijon.

Zyra e Komisionerit konstaton se, në projektligj, citoni dhe referoni në parashikimet e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Për rrjedhojë, ju bëjmë me dije se, aktualisht ka hyrë në fuqi ligji i ri nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim, “Ligji nr. 124/2024”), i cili shfuqizon ligjin e mëparshëm. Ligji nr. 124/2024 është baza e re ligjore, e përafuar me legjislacionin e BE-së, konkretisht me Rregulloren e Përgjithshme Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2016/679 dhe Direktivën e Policisë 2016/680, me qëllim përforcimin dhe garantimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale.

Lidhur me sa më sipër, Zyra e Komisionerit sugjeron të merrni masa për përditësimin dhe saktësimin e bazës ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale, duke zëvendësuar togfjalëshin “ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar”, me togfjalëshin “ligji nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale””, në përmbajtjen e projektligjit.

Gjithashtu, bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 124/2024, si dhe në mënyrë që të unifikohet terminologjia e përdorur në përputhje me legjislacionin në fuqi të mbrojtjes së të dhënave personale, sugjerojmë që, në projektligj, togfjalëshi “përdorim i të dhënave” të zëvendësohet me togfjalëshin “përpunim i të dhënave”.

Për më tepër, referuar **pikës 22, të nenit 2 të projektligjit**, Zyra e Komisionerit ju sqaron se, përkufizimi i përcaktuar në të, i dedikohet “pseudonimizimi”, si një formë përpunimi e të dhënave personale, e parashikuar në pikën 20, të nenit 5 të Ligjit nr. 124/2024.

Në këtë kuadër, në të gjitha dispozitat e projektligjit, terminologjia e përdorur lidhur me të dhënat personale, duhet të jetë e bazuar në legjislacionin specifik që rregullon këtë fushë, ndaj, bazuar në Ligjin nr. 124/2024 të përafuar me kuadrin rregullator të Bashkimit Europian, Zyra e Komisionerit sugjeron që, fjala “depersonalizim”, të zëvendësohet dhe unifikohet me fjalën “pseudonimizim”.

Me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, Zyra e Komisionerit sugjeron, të saktësohen proceset përpunuese që do të kryejë operatori ekonomik, në cilësinë e përpunuesit, në raport me të dhënat e grumbulluara nga SIU.

Për këtë qëllim, propozojmë që, **pika 11, e nenit 2 të projektligjit**, të riformulohet me përmbajtje: “Operator ekonomik është një ofrues shërbimi i certifikuar, privat apo shtetëror, që mundëson transmetimin dhe leximin e të dhënave të udhëtimit, në sistemet e përdorura nga SIU”.

Në pikën 19, të nenit 2 të projektligjit, citohet përkufizimi i subjektit të të dhënave, si person fizik ose juridik, të cilit i përpunohen të dhënat që transmetohen nga transportuesi.

Zyra e Komisionerit sugjeron që, në përputhje me pikën 23, të nenit 5 të Ligjit nr. 124/2024, kjo pikë të riformulohet me përmbajtje: *“Subjekt i të dhënave” është çdo person fizik i identifikuar ose i identifikueshëm. Një person është i identifikueshëm nëse mund të arrihet në identifikimin e tij, duke iu referuar drejtpërdrejt ose tërthorazi një apo disa faktorëve identifikues të veçantë, si: emri, numri i identifikimit, të dhënat për vendndodhjen, një identifikues në internet, ose një apo më shumë faktorëve specifikë, lidhur me identitetin e tij fizik, fiziologjik, identitetin gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror”*.

Gjithashtu, me qëllim unifikimin terminologjik në përputhje me legjislacionin në fuqi, sugjerojmë që, **në pikën 4, të nenit 6 të projektligjit**, fjala *“sisteme”* të zëvendësohet me togfjalëshin *“bazë e të dhënave”*, si dhe **në nenin 11 të tij**, togfjalëshi *“punonjës i mbrojtjes së të dhënave personale”* të zëvendësohet me fjalën *“nëpunës i mbrojtjes së të dhënave personale”*.

Në respektim të parimeve dhe kriterëve të parashikuara në legjislacionin kombëtar të mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm të të dhënave dhe mbrojtjen e të dhënave personale të individëve, konstatohet se në disa nga pikat e projektligjit, përmbajtja e tyre nuk përputhet me dispozitat ligjore, tek të cilat referojnë. Në këtë kuadër, sugjerojmë që, **në pikën 1/a, të nenit 9 dhe pikën 3, të nenit 12 të projektligjit**, të saktësohet referenca ligjore në dispozitat dhe nenet përkatëse.

Në vijim, duke qenë se, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është autoriteti i pavarur që monitoron e mbikëqyr të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të këtij projektligji, gëzon cilësinë e Autoritetit Kombëtar Mbikëqyrës, si dhe ushtron kompetencat e përcaktuara në nenin 10 të tij, lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale të pasagjerëve/udhëtarëve.

Lidhur me sa më sipër, Zyra e Komisionerit sugjeron që, **pika 3, e nenit 2 të projektligjit**, si dhe **titulli i nenit 10 të tij**, të riformulohen me këtë përmbajtje: *“Autoriteti Kombëtar Mbikëqyrës për mbrojtjen e të dhënave personale”*.

Në mbështetje të nenit 82 të Ligjit nr. 124/2024, i cili parashikon kompetencat e Zyrës së Komisionerit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, sugjerojmë që, në **germën “a”, të nenit 10 të projektligjit**, fjala *“këshillon”* të zëvendësohet me fjalën *“bashkëpunon”*.

Në kuadër të parimit të përpunimit në përputhje me qëllimin, sipas pikës 2, të nenit 6 të Ligjit nr. 124/2024, të dhënat personale mblidhen për një qëllim specifik e të ligjshëm, të përcaktuar qartë në momentin e mbledhjes dhe nuk përpunohen më tej për një qëllim tjetër, që nuk është në përputhje me qëllimin fillestar.

Në respektim të këtij parimi ligjor, sugjerojmë që, **pika 1/ç, e nenit 15 të projektligjit**, të riformulohet në mënyrë të qartë e specifike, mbi qëllimin për të cilin SIU grumbullon dhe përpunon të dhënat e udhëtimit.

Sa më sipër, me reflektimin e propozimeve të sipërpërmendura, projektligji vlerësohet i hartuar në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi